

12.01.2024

Ora, 10:11

**RENDI I DITËS**

**“Për pranimin për shqyrtim të kërkesës së Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 01, datë 08.01.2024”.**

**PJESËMARRJA :**

- **KAS:** Z. Elvin Lako, z. Elvis Çefa, z. Ilirjan Rusmali, z. Koli Bele, z. Ledio Braho.
- **Stafi KQZ:** Z.Y.Merkaj, znj.J. Josifi, z.K.Puleri, z.E. Mema.
- **Parti Politike:** PD (z. I. Sefa), G 99 (z. R. Shtino)
- **Të tjerë:** Bashkia Durrës (z. A.Kaçupi, z. E. Lufo)  
Bashkia Rrogozhinë (znj. E. Memolla)

**Z. E. Çefa:** Mirëdita të gjithëve. Çelim seancën për shqyrtimin paraprak të elementëve të formës dhe përmbajtjes të kërkesës së Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve me nr. 1 datë 8 janar 2024, për propozim “Për vendosje sanksionesh administrative”. Koncretisht ndaj subjektit politik Partia Socialiste e Shqipërisë gjobë në masën tre milion lekë. Subjektin politik Partia Demokratike gjobë në masën tre milion lekë. Subjektin politik Partia Demokratike gjobë në masën 500000lekë. Subjektin zgjedhor Partia Demokratike gjobë në masën 100000lekë. Kandidatit për kryetar bashkie të Partisë Socialiste zonjës Emirjana Sako gjobë në vlerën 92775 lekë. Kandidatit për kryetar bashkie të Partisë Socialiste zotit Edison Memolla gjobë në vlerën 120590 lekë. Kandidatit të Koalicionit “Shtëpia e Lirisë” për kryetar bashkie zotit Bardh Spahia gjobë në vlerën 91420 lekë dhe kandidatit për kryetar bashkie nga Koalicioni “Shtëpia e Lirisë”, zotit Ardian Muka gjobë në vlerën 415000

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 12.01.2024*

lekë. Sipas shortit të hedhur në KQZ relatori do të jem unë, anëtar i KAS-it Elvis Çefa. Verifikojmë fillimisht prezencën. Është prezent trupa e plotë e KAS-it, është prezent Sekretari i Përgjithshëm dhe stafi i tij, që në këtë procedim administrativ do të përfaqësojnë Komisionerin Shtetëror të Zgjedhjeve. Ka prezencë nga ana e interesuar, nga subjektet? Po!

**Z. I. Sefa, përfaqësues i PD:** Partia Demokratike përfaqësuar nga përfaqësuesi i përhershëm pranë KQZ-së, Indrit Sefa.

**Z. E. Çefa:** Faleminderit zoti Sefa. Subjekte të tjera të interesuara? Po, me mikrofon ju lutem

**Z. A. Kaçupi, përfaqësues i zonjës E. Sako:** Nga zonja Emiljana Sako dy përfaqësues, Ermal Lufo dhe Alvaro Kaçupi

**Z. E. Çefa:** Autorizimin besoj e keni depozituar?

**Z. A. Kaçupi, përfaqësues i zonjës E. Sako:** Jo, e kemi këtu me vete, nuk e njohim procedurën...

**Z. E. Çefa:** Atëherë depozitoheni ju lutem!

**Znj. E. Memolla, përfaqësuese e zotit E. Memolla:** Erinda Memolla, përfaqësuese e kandidatit të zgjedhjeve të 6 marsit Edison Memolla.

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 12.01.2024*

**Z. E. Çefa:** Faleminderit! Autorizimin ju lutem zonjushë! Persona të tjerë të interesuar? Nuk kemi! Atëherë mund të vijojmë. Sipas procedurës jam i detyruar t'ju pyes, nëse jeni dakord me trupën, apo keni diçka kundrejt trupës? Nuk ka! Kështu mund të vazhdojmë. Ateherë shkurtimisht i jap fjalën Sekretarit të Përgjithshëm që të na relatojë pak, kërkesën e Komisionerit përpara KAS-it. Zoti Merkaj fjala për ju.

**Z. Y. Merkaj:** Atëherë, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka zhvilluar një procedure administrative ku ka marrë në shqyrtim raportet e gjetjeve nga auditimi i fondeve të përfituara e të shpenzuara nga partitë politike, pjesëmarrëse në zgjedhjet e datës 6 mars 2022. Në përfundim të shqyrtimit administrativ Komisioneri ka gjetur gjithë raportet dhe gjetjet e raporteve i ka konsideruar dhe i ka vlerësuar se disa parti politike, subjekte zgjedhore, që kanë marrë pjesë në zgjedhje në datën 6 mars, kanë shkelur detyrimet ligjore dhe i ka propozuar KAS-it marrjen e masave administrative për Partinë Socialiste, Partinë Demokratike, për kryetaren e Bashkisë Durrës zonjën Emirjana Sako, për kryetarin e Bashkisë Rrogozhinë, zotin Edison Memolla, për kandidatin për kryetar bashkie, zotin Bardh Spahia dhe për zotin Ardian Muka, ka propozuar sanksione administrative sipas vendimit. Nga shqyrtimi paraprak i kërkesës së Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve konstatohet se i plotëson elementët formalë të parashikuar nga neni 110 dhe 126 i Kodit Zgjedhor, gjithashtu dhe nenit 35 të Rregullores së KAS-it. Për këtë arsye i kërkojmë KAS-it kalimin e kërkesës së Komisionerit për shqyrtim në seancë publike. Faleminderit!

**Z. E. Çefa:** Ju faleminderit! Nga palët, përfaqësuesit e personave të interesuara në këtë fazë të shqyrtimit. Po zoti Sefa!

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 12.01.2024*

**Z. I. Sefa, përfaqësues i PD:** Unë shoh që nga ana e KQZ-së është vetëm propozimi drejtuar KAS-it, por nuk shoh...ka një pretendim që janë zyra elektorale dhe të gjitha me rradhë, por nuk shoh një provë, nuk kam praktikën me provat. Si e vërteton që është zyrë elektorale? Unë kam qenë kandidat në 6 mars. Sipas KQZ-së ka pasur dy shtabe elektorale. E vërteta është që ka qenë vetëm selia e Partisë Demokratike. Ambjenti tjetër që presupozojmë ka qenë vetëm i vendosur me banera... mund të ketë qenë ambjent...

**Z. E. Çefa:** Kam përshtypjen që kjo i përket themelit. Përsa i përket provave atëherë do t'i lutem administratës, t'i vendosë zotit Sefa në dispozicion gjithë setin e provave që i kanë shërbyer Komisionerit për marrjen e këtij vendimi. Ndërkohë që ai të ketë kohë të përgatitet për gjykimin e themelit të kësaj çështje kur ta caktojme datën. Nga personat e tjerë? Atëherë edhe unë personalisht, në cilësinë e relatorit e konstatoj që kjo kërkesë vjen në përputhje me Kodin Zgjedhor fillimisht, si dhe me nenin 35 të rregullores së funksionimit të KAS-it. Kështu unë besoj që duhet të kalohet për shqyrtim.

Atëherë, KAS i konsultuar në vend, vendosi:

- Kalimin në seancë shqyrtimi në themel të kërkesës nr. 1 të Komisionerit “Për vendosje sanksioni administrativ”.
- Seanca për shqyrtimin në themel të kësaj çështje kërkesë do të zhvillohet ditën e martë në datë 16 janar 2024 në orën 13:30.

Me kaq kjo seancë deklarohet e mbyllur. Ju faleminderit të gjithëve.

**Vendimi nr. 02**

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 12.01.2024*

12.01.2024

Ora, 10:24

***RENDI I DITËS***

**“Për shqyrtimin paraprak të kërkesës ankimore nr. 02, datë 04.01.2024 të depozituar nga zoti Edison Memolla”.**

**PJESËMARRJA :**

- **KAS:** Z. Elvin Lako, z. Elvis Çefa, z. Ilirjan Rusmali, z. Koli Bele, z. Ledio Braho.
- **Stafi KQZ:** Z.Y.Merkaj, znj.J. Josifi, z.K.Puleri, z.E. Mema.
- **Parti Politike:** S’ka
- **Të tjerë:** Bashkia Rrogozhinë (znj. E. Memolla)

**Z. I. Rusmali:** Përshëndetje! Fillojmë seancën për shqyrtimin paraprak të kërkesës ankimore të paraqitur nga Edison Memolla, kandidat për kryetar bashkie i Bashkisë Rrogozhinë, në zgjedhjet e datës 6 mars 2022. Të pranishëm në këtë seancë janë trupa e KAS-it në përbërje të plotë, Sekretari i Përgjithshëm me ekipin e tij në përbërje të plotë, është gjithashtu dhe përfaqësuesja me autorizim, ju lutem prezantohuni!

**Znj. E. Memolla, përfaqësuese e zotit E. Memolla:** Erinda Memolla përfaqësues i kandidatit të Partisë Socialiste në zgjedhjet e 6 marsit, Edison Memolla.

**Z. I. Rusmali:** Mirë faleminderit! Kërkesa ankimore ka për objekt kundërshtimin e vendimit të Komisionerit nr. 824 me të cilin ai ka vendosur ti kërkojë KAS-it që të shqyrtojë dhe të vendosë masë gjobe, sanksion ndaj kandidatit për shkelje të

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 12.01.2024*

dispozitave të Kodit lidhur me raportimin. Komisioneri lidhur me këtë vendim të tij ka paraqitur sipas vendimit kërkesë drejtuar KAS-it që KAS-i të shqyrtojë dhe të vendosë. Nga ana tjetër formalisht kandidati ka paraqitur kërkesë ankimore ndaj vendimit. Qëndrimi që ka mbajtur KAS-i në të gjitha këto raste është që vendimet e kësaj natyre nuk sjellin asnjë pasojë në interesat legjitime të subjekteve, sepse pasojat i sjell kërkesa e komisionerit drejtuar KAS-it dhe jo vendimi i tij për t'ju drejtuar KAS-it. Si trupë ne kemi mundësinë që të marrim vendim për ta pushuar çështjen për këtë shkak, për shkak të mungesës së interesit të ligjshëm në ndjekjen me kërkesë ankimore, duke mos cënuar interesat e palës, sepse pala ka të drejtën që të paraqitet në seancën e shqyrtimit të kërkesës së Komisionerit. Ose kemi dhe opsionin që pala tërhiqet nga kërkesa ankimore dhe i ndjek të drejtat e veta në rrugën e procedurës që do të zhvillohet për shqyrtimin e kërkesës së Komisionerit. Ju si palë çfarë mendoni për këtë?

**Znj. E. Memolla, përfaqësuese e zotit E. Memolla:** Mendoj.., duke qenë se ka të njëjtat efekte, do të tërheq kërkesën ankimore.

**Z. I. Rusmali:** Mirë faleminderit. Atëherë nuk mbetet gjë tjetër vetëm që këtë seancë ta mbyllim duke ...ta pushojmë çështjen duke marrë në konsideratë tërheqjen e palës nga kërkesa ankimore dhe ta ftojme palën që të jetë prezent në seancën e shqyrtimit në themel të kërkesës së Komisionerit, që siç u tha këtu, do të zhvillohet ditën e martë në orën 13.30. Faleminderit! Me kaq e mbyllim këtë seancë.

**Vendimi nr. 03**

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 12.01.2024*

12.01.2024

Ora, 10:28

**RENDI I DITËS**

**“Për pranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 01, datë 04.01.2024 të depozituar nga subjekti “Partia Popullore Kristiandemokrate e Shqipërisë”.**

**PJESËMARRJA :**

- **KAS:** Z. Elvin Lako, z. Elvis Çefa, z. Ilirjan Rusmali, z. Koli Bele, z. Ledio Braho.
- **Stafi KQZ:** Z.Y.Merkaj, znj.J. Josifi, z.K.Puleri, z.E. Mema.
- **Parti Politike:** PPKDSH (znj. Orjeta Shkambi)
- **Të tjerë:** Z. P. Shkambi

**Z. K. Bele:** Mirë vazhdojmë, çelim seancën paraprake për shqyrtimin e kërkesës ankimore me nr.1 drejtuar KAS, nga ankuesi, subjektit politik Partia Popullore Kristiandemokrate e Shqipërisë, përfaqësuar nga nënkryetarja e partisë zonja Orjeta Shkambi, me objekt “Kundërshtimin e vendimit nr. 823, datë 07.12.2023 të KSHZ, “Për miratimin e raportit të gjetjeve nga auditimi i fondeve të përfituara të shpenzuara nga partitë politike për vitin kalendarik 2021”. Prezent është trupa e KAS-it me 5 anëtarë, administrata e KQZ-së drejtuar nga Sekretari i Përgjithshëm, si dhe përfaqësues i ankuesit. Kemi në seancë? Me mikrofon të lutem, po...

**Znj. O. Shkambi, përfaqësuese e PPKDSH:** Përshëndetje të gjithëve. Unë jam nënkryetarja e Partisë Popullore Kristiandemokrate të Shqipërisë Orjeta Shkambi.

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 12.01.2024*

**Z. K. Bele:** Faleminderit! Në këtë fazë ka nga ana e palëve prezente ndonjë objeksion apo vërejtje për përbërjen e trupës së KAS-it?

**Znj. O. Shkambi, përfaqësuese e PPKDSH:** Jo, nuk kemi!

**Z. K. Bele:** Kemi palë të tjera prezente, lidhur me këtë kërkesë ankimore? Nuk ka. Atëherë i japim fjalën Sekretarit të Përgjithshëm, zoti Merkaj të na relatojë shkurtimisht objektin e kësaj kërkesë.

**Z. Y. Merkaj:** Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve në seancë administrative ka marrë në shqyrtim raportet e gjetjeve të auditëve të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga partitë politike për vitin kalendarik 2021. Në përfundim të procedurës administrative Komisioneri ka vendosur ndër të tjera, “miratimin e gjetjeve të raporteve të auditimit të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga partitë politike për vitin kalendarik 2021”, sipas shtojcës që i bashkëngjitet këtij vendimi. Ku në shtojcë një nga subjektet politike që kanë marrë pjesë është dhe Partia Popullore Kristiandemokrate e Shqipërisë, e cila është gjobitur me vlerën 60000 lekë. Kundër këtij vendimi ka bërë ankim Partia Popullore Kristiandemokrate e Shqipërisë. Nga shqyrtimi paraprak i kësaj kërkesë ankimore konstatohet se dy elementët e parashikuar në nenin 130 të Kodit Zgjedhor kompetencë e KQZ-së shqyrtimi i ankimit plotësohet si respektim i afateve ligjore të ankimit. Në lidhje me legjitimitimin e akuzuesit shohim që kërkesa ankimore është firmosur nga nënkryetarja e partisë. Koorespondenca është mbajtur me kryetarin e partisë zotin Pjerin Kondraçaj. Nuk e di nga i buron e drejta nënkryetares nga statuti apo ndonjë vendim asambleje. Ne jemi të paqartë dhe i propozojmë KAS-it ta kthejë kërkesën

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 12.01.2024*

për plotësim deri sa të verifikohet kompetenca e nënkryetares në lidhje me nënshkrimin e kësaj kërkesë ankimore. Faleminderit!

**Z. K. Bele:** Mirë këtë moment procedural ne mund ta sqarojmë meqenëse pala është prezente. A keni tagër zonjë ta përfaqësoni partinë me një akt të caktuar që buron nga statuti, apo autorizim? Pse e përfaqësoni ju partinë, me fjalë të tjera?

**Znj. O. Shkambi, përfaqësuese e PPKDSH:** Unë e përfaqësoj këtë parti në bazë të statutit të partisë që kemi ngrit. Meqenëse kryetari ka dhënë dorëheqjen në gjykatë. Pra, ka dhënë dorëheqjen nga partia dhe është paraqitur në gjykatë kërkesa dhe për arsye të kësaj unë e kam të drejtën dhe tagrin që ta përfaqësoj këtë parti.

**Z. Pal Shkambi:** Mund t'jua shpjegoj unë shumë thjesht ju lutem?

**Z. I. Rusmali:** Po, po na e shpjego!

**Z. Pal Shkambi:** Përshëndetje! Atëherë faleminderit dhe, vit i mbarë për të gjithë! Unë jam Pal Shkambi, kjo është nusja ime në rradhë të parë për të qenë shumë transparent e para. E dyta këtë parti e kam ndërtu unë me studenta në vitin 2011. E treta, në 2017 unë kam dhënë dorëheqje për të mbështetur drejtësinë që po bëhet sot dhe sigurisht partia dhe me e mbyll dhe me e hap, kollaj nuk është ajo punë, sepse edhe me dash me e mbyll duhen mbledh kongresi e shumë problematika. Nga partia është zgjedhur në 2017, zoti Pjerin Kondraçaj sikur e tha sekretari dhe ai ka dhënë dorëheqje dhe dorëheqja është paraqitur në gjykatë. Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, mirëpo edhe gjykata nuk ka vendosë ende. Është mbledhur kryesia dhe bashkë me Këshillin Kombëtar më pas, duke e drejtuar sekretarja e përgjithshme dhe

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

*Dt. 12.01.2024*

i kanë dhënë tagër nënkryetares, që është zonja Orjeta këtu. Në këtë moment ka ardhur gjithmonë, sepse kemi marrë një informacion kemi marrë një shkresë zyrtare. Orjeta ka marrë në pozicionin, në selinë e partisë, ka ardhur një shkresë dhe Orjeta ka komunikuar me ekspertin kontabël, me audituesin që bën kontrollin e partisë në bazë të ligjit duke e udhëzuar Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Në këto rrethana Orjeta ka komunikuar me zotin auditues, me ekspertin kontabël, zotin Tirana dhe mbas dy ditësh ka marrë në telefon...

**Z. I. Rusmali:** Ju lutem mos të shkojmë te kjo, se te kjo do të vijmë më vonë. Jemi te fjalja Këshilli Kombëtar dhe kryesia kanë marrë vendim që partinë ta përfaqësojë zonja. Këtë dokument e keni ju?

**Z. Pal Shkambi:** Dokumentin...e ka statuti i partisë, pa dokumente e pa gjë... dhe statuti e jep shumë qartë që një nënkryetar..., në rastin kur është i sëmurë kur jep dorëheqje..., është nënkryetari ai që e përfaqëson partinë, që e drejton partinë.

**Z. I. Rusmali:** Na e dorëzo pak këtë statut!

**Z. Pal Shkambi:** Statutin nuk e kam këtu me vete, por statuti kështu është pikë për pikë. Nuk e kam këtu me vete statutin. Kjo është e vërteta.

**Z. I. Rusmali:** Thatë e kam statutin...

**Z. Pal Shkambi:** Jo jo, statutin e kemi. Ai është në gjykatë, e kemi ne është te noteri, është gjithëkund. Domethënë statuti është në këto institucione. Ndoshta dhe në KQZ është...

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 12.01.2024*

**Z. K. Bele:** Zoti Pal, nuk është se kemi ndonjë merak ...

**Z. Pal Shkambi:** Kështu është statuti, faleminderit që më pyete për ta legjitimuar. Është me vend ajo pyetja juaj, por e thotë shprehimisht...

**Z. K. Bele:** Dakord! Mjafton shpjegimi, ne duke qenë organ administrativ kërkojmë një fije letër që lidh fjalën me atë që ne themi.

**Z. Pal Shkambi:** Në seancën tjetër do t'jua sjellim pa diskutim dhe do të prezantojmë duke e theksuar nenin dhe paragrafin që përcakton qartë. Ju faleminderit në lidhje me këtë gjë. Në lidhje me ecurinë e perceptimit, ne kemi ardhur këtu sot, zonja dmth ka ardhur këtu sot për të përfaqësuar partinë në lidhje me..., sepse është vënë një gjobë e pathemeltë...

**Z. K. Bele:** E para do ta thuash më vonë dhe e dyta do ta thotë ai që ka tagër ta thotë. Pra, nqs do ta përfaqësoni ju me një autorizim, a me diçka do ta thoni ju. Nqs do ta përfaqësojë zonja, do ta thotë zonja. Mund t'ia shkruani ju, por do ta thotë ai që ka tagër.

**Z. Pal Shkambi:** E ka të shkruar kjo. Unë nuk doja të vonohesha. Faleminderit dhe për mundësinë që më dhatë.

**Z. K. Bele:** Faleminderit! Ne vazhdojmë seancën sa të zgjidhim këtë. Faleminderit. Mund ta mbyllni mikrofonin.

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 12.01.2024*

**Z. E. Çefa:** Unë kam një pyetje për administratën. Ju lutem na sqaroni pak disponimin e Komisionerit me këtë vendimin objekt-ankimi. Çfarë ka vendosur Komisioneri? Unë e lexova vendimin. Më duket shumë telegrafik në të folur.

**Z. Y. Merkaç:** Atëherë vendimi shoqërohet me raportin e gjetjeve i cili është disa faqe. Vendimi është shumë i thatë dhe shumë shkurt se të gjitha arsyetimet janë të raporti i gjetjeve që është bashkëlidhur, është pjesë përbërëse e vendimit të Komisionerit. Të raporti i gjetjeve shpjegohet dhe arsyeja pse kjo parti...

**Z. E. Çefa:** Këtë e kuptoj zoti Merkaç, por dua të di Komisioneri ka vendosur që të propozojë apo ka vendos që të marr gjoba? Vullneti i Komisionerit i materializuar në këtë vendim këtu?

**Z. Y. Merkaç:** Ka vendos gjoba, se neni 23, pika 4 i Ligjit për Partitë Politike ...

**Z. E. Çefa:** Ka vendosur drejtëpërdrejtë gjobën pra?

**Z. Y. Merkaç:** Është kompetencë e Komisionerit për të vendosur gjoba, sipa nenit 23, pika 4 i Ligjit për Partitë Politike.

**Z. E. Çefa:** Dakord!

**Z. Pal Shkambi:** Ju lutem a mund të shpjegoj rrethanat?

**Z. K. Bele:** Nuk jemi në këtë fazë.

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 12.01.2024*

**Z. K. Bele:** Dakord! Faleminderit! KAS tërhiqet për të marrë vendimin.

**Rifillon seanca**

**Ora 10:55**

**Z. K. Bele:** Mirë e riçelim seancën atje ku e lamë. Lidhur me momentin e legjitimitetit të subjektit ankues Partia Popullore Kristiandemokrate e Shqipërisë, duke pranuar atë që u parashtrua nga ana e nënkryetares. Sipas premtimit tuaj në seancë do të administrojmë dokumentin përkatës që ju do të sillni kur do të caktohet seanca. Për tu kthyer te vendimi, objekt i ankimit. Duke qenë se vendimi objekti i ankimit mbështetur në ligjin “Për Partitë Politike”, ka vendosur një numër sanksionesh nga ana e KSHZ-së për 104 subjekte, në mos gaboj dhe datë, konstatoj sipas relatimit të Sekretarit të Përgjithshëm dhe materialit përkatës, konstatojmë që datë e vendosjes së këtyre sanksioneve, vendimi është i dates 7 dhjetor i vitit 2023. Në vendim është relatuar si afat ankimi afati i përgjithshëm 30 ditor për ankimin në KAS. Nga analiza e dispozitës dhe ligjit në tërësi, rezulton që afat për këtë proces administrativ, afat i aplikueshëm i përgjithshëm, do të jetë afati që buron nga Kodi i Procedurave Administrative, afati 45 ditë nga dita e njoftimit. Për të respektuar këtë afat, i cili në vlerësimin e KAS është afat i aplikueshëm, si dhe për t’i garantuar subjekteve të drejtën e plotë të ankimit për të patur një proces të rregullt ligjor, seanca e rradhës për këtë çështje do të shtyhet në një datë, e cila kënaq kushtin ligjor të afatit. Kjo, do të thotë që, njoftimet janë kryer në datë 21 dhjetor, për të kapur afatin, data e caktuar për seancën e rradhës do të jetë data 12 shkurt 2024, ora 12:00. Çfarëdo ankimi, për këtë çështje, për efekt të procedurës do të bashkohen dhe të trajtohen në atë seancë. E mbyllim seancën.

**Vendimi nr. 04**

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 12.01.2024*

12.01.2024

Ora, 11:00

**RENDI I DITËS**

**“Për pranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 03, datë 08.01.2024 të depozituar nga subjekti ‘Partia G 99’.**

**PJESËMARRJA :**


- **KAS:** Z. Elvin Lako, z. Elvis Çefa, z. Ilirjan Rusmali, z. Koli Bele, z. Ledio Braho.
- **Stafi KQZ:** Z.Y.Merkaj, znj.J. Josifi, z.K.Puleri, z.E. Mema.
- **Parti Politike:** G 99 (z. Redi Shtino)
- **Të tjerë:**

**Z. L. Braho:** Mirë atëherë çelim seancën për shqyrtimin e elementëve të formës dhe përmbajtjes të kërkesës ankimore nr. 3, datë 8 janar 2024, ankues është partia G 99, me kryetar zotin Redi Shtino. Nëpërmjet kësaj kërkesë ankimore kundërshtohet vendimi i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 823 datë 07.12.2023, që ka të bëjë me “miratimin e raporteve të zgjedhjeve dhe miratimin e fondeve të miratuara dhe të shpenzuara nga partitë politike për vitin kalendarik 2021”. I pranishëm është Sekretari i Përgjithshëm i KQZ-së, i cili përfaqëson komisionerin në këtë seancë. I pranishëm është dhe...

**Z. R. Shtino, kryetar i Partisë G 99:** Kryetari i partisë, Redi Shtino.

**Z. L. Braho:** Mirë atëherë, e pranishme është trupa e plotë e KAS-it. Ka ndonjë kërkesë për trupën, ndonjë pretendim?

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 12.01.2024*

**Z. R. Shtino, kryetar i Partisë G 99:** Jo, marrim në vlerësim shqyrtimin e çështjes.


**Z. L. Braho:** Dakord, faleminderit! Mirë atëherë, zoti Merkaj me pak fjalë në lidhje me e elementët të formës dhe përmbajtjes për këtë kërkesë.

**Z. Y. Merkaj:** Ashtu siç relatova dhe më parë, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendim, 823 datë 07.12.2023, ka miratuar raportin e gjetjeve nga auditimi i fondeve të miratuara dhe të shpenzuara nga partitë politike për vitin kalendarik 2021. Te dispozitivi i vendimit ndër subjektet që kanë marrë gjobë, ose ka vendosur gjobë Komisioneri është dhe Partia G 99. Nga shqyrtimi paraprak i kërkesës ankimore paraqitur nga Partia G 99, konstatohet se i plotëson të tre elementët e formës dhe përmbajtjes, të parashikuar nga neni 130 i Kodit Zgjedhor. Për këtë arsye i kërkojmë KAS-it kalimin e kërkesës në seancë publike për shqyrtim. Faleminderit!

**Z. L. Braho:** Faleminderit! Fjala për ju zoti Shtino. Keni sjellë dhe një letër këtu që tregon status pasiv. Na sqaroni pak për statusin e partisë politike.

**Z. R. Shtino, kryetar i Partisë G 99:** Atëherë kërkesa lidhet me faktin që partia që në 26 qershor të 2019-s ka status financiar pasiv. Kjo është e dokumentuar nga shkresa bashkëlidhur. Për të njëjtën arsye nuk kemi depozituar në vijim tabelat që përshkruajnë aktivitete të ndryshme në fushën financiare gjatë procesit zgjedhor dhe për këtë arsye kemi bërë dhe rekursin. Pra, nëse shihni në tabelë, ka dy momente ka themelimin më, 10.01.2012 deri më 25.06.2019 statusi ka qenë aktiv, ndërkohë me kërkesë më datë 26.06.2019 e në vazhdim, pra deri sot, statusi i partisë është pasive.

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 12.01.2024*

**Z. L. Braho:** Ndërkohë në regjistrin e partive politike është aktive, pasi nuk besoj që mund të pezullohet një parti politike. Pra, e hap dhe alternativa tjetër është ta mbyllësh si parti politike. Nuk besoj se atje ka një ...

**Z. R. Shtino, kryetar i Partisë G 99:** Këtu po flasim për statusin financiar.

**Z. L. Braho:** Po, por tani, unë po të pyes për regjistrin e partive politike, sepse më intereson në këtë fazë vetëm për legjitimitetin, për themelin do të flasim në seancën tjetër.

**Z. R. Shtino, kryetar i Partisë G 99:** Është aktive.

**Z. L. Braho:** Është aktive dhe jeni ju kryetari i zgjedhur.

**Z. R. Shtino, kryetar i Partisë G 99:** Po!

**Z. L. Braho:** Mirë, dakord. Ndonjë pyetje nga kolegët? S'ka! Mirë atëherë, KAS i konsultuar në vend vendosi:

- Kalimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 3 të dates 8.01.2024 të subjektit ankimues, partia politike G 99.
  - Bashkimin me kërkesat ankimore nr. 1 dhe shqyrtimin e kësaj kërkesë në seancë të shqyrtimit administrativ në datën 12 shkurt ora 12:00.
- Seancën e deklaroj të mbyllur.

**Vendimi nr. 05**

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*





*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 12.01.2024*

12.01.2024

Ora, 11:05

**RENDI I DITËS**

**“Për pranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 04, datë 29.12.2023 të depozituar nga subjekti “Partia Aleanca Popullore”.**


**PJESËMARRJA :**

- **KAS:** Z. Elvin Lako, z. Elvis Çefa, z. Ilirjan Rusmali, z. Koli Bele, z. Ledio Braho.
- **Stafi KQZ:** Z.Y.Merkaj, znj.J. Josifi, z.K.Puleri, z.E. Mema.
- **Parti Politike:** S’ka
- **Të tjerë:** S’ka

**Z. E. Lako:** Mirë, atëherë fillojmë shqyrtimin në seancë paraprake, zoti Merkaj, të kërkesës ankimore nr. 4, me ankues Partinë Aleanca Popullore sipas këtij objekti kundërshtimin e vendimit 823, date 07.12.2023, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për miratimin e raportit të gjetjeve të fondeve të miratuara të përfituara nga partitë politike për vitin kalendarik 2021”. Konkretisht shfuqizimin e pikës 101 të këtij vendimi. Në seancë është prezent trupa e KAS-it, administrata. Për palën ankuese nuk ka përfaqësues, por sipas administratës, ankimi është shkruar nga kryetari i kësaj partie. Ju lutem zoti Merkaj dy fjalë rreth ankimit.

**Z. Y. Merkaj:** Në vendimin 823, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve është vendosur marrja e masës administrative për partinë politike Aleanca Popullore gjobë në masën një milion lekë. Kundër këtij vendimi duke mos rënë dakord, ka bërë ankim Partia Aleanca Popullore. Nga shqyrtimi i kërkesës ankimore, konstatohet se

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 12.01.2024*

i plotëson të tre elementët të formës dhe përmbajtjes, parashikuar nga neni 130 i Kodit Zgjedhor. Në këto kushte i kërkojmë KAS-it kalimin e kërkesës për shqyrtim në seancë publike. Faleminderit!

**Z. E. Lako:** Mirë faleminderit zoti Merkaj! Nga kolegët ka ndonjë pyetje? Jo? Atëherë, të konsultuar në vend mendojmë që edhe kjo çështje të kalojë për shqyrtim dhe seanca e radhës do të jetë ashtu si dhe për çështjet e tjera, do të bashkohet me çështje që kanë të njëjtin objekt. Pra, kundër të njëjtit vendim të Komisionerit, në datën 12 shkurt në orën 12:00! Të njoftohet pala ankuese. Me kaq e deklaroj të mbyllur seancën. Faleminderit!

**Vendimi nr. 06**

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*

